



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë 29.03.2021

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë

Për: Operatorin ekonomik: “**Milifar**” sh.p.k me NIPT **J81426001I**

Adresa: Rruga “Xhorxhi Martini”, Pall.9, Tiranë

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-86764-02-11-2021

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim**”, kohëzgjatja e kontratës deri **24 muaj** nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: 34 166 000 (*tridhjetë e katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë*)
lekë pa TVSH

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.03.2021

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik: “**Albania Distribution Chem**” sh.p.k me NIPT **L82203011N**, me ofertë ekonomike: **24 850 000** (*njëzet e katër milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë*)
lekë pa tvsh.

2. Operatori ekonomik: “**Milifar**” sh.p.k me **NIPT J81426001I**, me ofertë ekonomike **33 561 200** (*tridhjetë e tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind*) **lekë pa tvsh.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1) Operatori ekonomik: “Albania Distribution Chem” sh.p.k me NIPT L82203011N, për arësyet e mëposhtme:

1. Nuk plotëson pikën 2.2 4) të kapacitetit ekonomik dhe financiar Shtojca 9 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit. Nga shqyrtimi i faturave për furnizimet e ngjashme të dorëzuara në SPE rezulton se janë kryer shitje vetëm për tre nga produktet objekt të prokurimit Hipoklorit Kalciumi, Hipoklorit Natriumi dhe Peroksid Hidrogjeni. Nuk është paraqitur asnjë faturë ku të vërtetohet shitje të ngjashme për insekticidet dhe rodenticidet (11 produktet e tjera).

2. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.9 Insekticid për luftimin e furrtareve** (Foval Gel Ultra Scarafaggi, prodhues Kollant s.r.l, Itali) është paraqitur me përkthim të pa noterizuar.

3. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.12 Produkte të gatshme për luftimin e grerëzave** (Bifent Fogger Plus, prodhues ICB Pharma, Poloni), është paraqitur me përkthim të pa noterizuar. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.12 Produkte të gatshme për luftimin e grerëzave** (Antivespe, prodhues Kollant s.r.l, Itali) është paraqitur me përkthim të pa noterizuar.

4. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.11 Preparat Repelent** (BL Natural Rettili, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali) është paraqitur me përkthim të pa noterizuar.

5. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.10 Rodenticid për luftimin e minjve** (Bromobleu Block, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali), është paraqitur me përkthim të pa noterizuar.

6. Nuk plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Shtojcën Nr.10 specifikimet teknike **produktin Nr.10 Rodenticid për luftimin e minjve**. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar lëndën bazë të rodenticidit Coumatetralyl (CAS no. 5836-29-3) me përqëndrim 0.03%-0.04% kurse është ofertuar produkti (Bromobleu Block, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali) i cili ka në përbërje lëndë bazë Bromadiolone (CAS no. 28772-56-7) me përqëndrim 0.005%.

7. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.6 Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse për ambiente të jashtme** (Blattoxur Delta, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali), është paraqitur me përkthim të pa noterizuar.

8. Nuk plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Shtojcën Nr.10 specifikimet teknike **produktin Nr.6 Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse për ambiente të jashtme**. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar lëndën bazë të Produktit Deltamethrinë (CAS no.52918-63-5) në përqëndrim 1.5% - 2%, kurse është ofertuar produkti (Blattoxur Delta, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali) i cili ka në përbërje lëndë bazë Deltamethrinë (CAS no.52918-63-5) në përqëndrim 1% - 1.5%.

9. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.7 Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse për ambiente të brendshme** (Bleu Delta, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali), është paraqitur me përkthim të pa noterizuar.

10. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë. Skeda e të dhënave të sigurisë për **produktin Nr.8. Insekticid natyral për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse në ambiente sensitive** (Piretro 714, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali), është paraqitur me përkthim të pa noterizuar.

11. Nuk plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Shtojcën Nr.10 specifikimet teknike **produktin Nr.8. Insekticid natyral për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse në ambiente sensitive**. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar lëndën bazë të Produktit Pyrethrin (CAS no.8003-37-7) ose Pyrethrum (CAS no.89997-63-7) në përqendrim 2.5% -3.5%, kurse është ofertuar produkti (Piretro 714, prodhues Bleu Line s.r.l, Itali) i cili ka në përbërje lëndë bazë Pyrethrin (CAS no.8003-37-7) në përqendrim 1.75%.

12. Nuk plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Shtojcën Nr.10 specifikimet teknike **produktin Nr.3. Biocid dizinfektant me spektër të veprimit kundër viruseve, baktereve, kërpudhave, mykut etj.** Autoriteti kontraktor ka përcaktuar lëndën bazë të produktit Benzyl-C12-16-alkyldimethyl chlorides (CAS no.68424-85-1) 15%-30%, Didecyldimethyl Ammonium Chloride (CAS,no.7173-51-5) 5%-15%, Glutaradehyde (CAS no.111-30-8) 5%-15%, kurse është ofertuar produkti (Flor DDAC, prodhues Florfarma shpk Shqipëri) i cili ka në përbërje lëndë bazë Didecyldimethyl Ammonium Chloride (CAS,no.7173-51-5) në përqendrim 10% dhe Alkool izopropilik në përqendrim 5%. Këto të dhëna teknike të referuara në Skedën e të dhënave të sugurisë (MSDS) për produktin të paraqitur në SPE rezultojnë të ndryshme nga ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

13. Nuk plotëson pikën 2.3 g) të Kapacitetit Teknik, Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi nuk është paraqitur raport testimi nga laborator i akredituar për të vërtetuar efikasitetin kundër viruseve dhe efektin jokorrodues në mjedis, të produktit me emërtimin “Biocid dezinfektant kundër baktereve, viruseve dhe kërpudhave” (Nr. Rendor 3(tre) i listës së paraqitur në tabelën e Shtojcës Nr.10).

14. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë pasi Fragmenti i katalogut/Skeda teknike për **produktin nr.13 Produkt për kapjen insekteve zvarritëse** është paraqitur i papërkthyer dhe i pa noterizuar.

15. Nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranim Kualifikimit Shtojca 9, paragrafi i tretë pasi Fragmenti i katalogut/Skeda teknike për **produktin nr.14 14. Kuti plastike për vendosjen e rodenticideve** është paraqitur i papërkthyer dhe i pa noterizuar.

16. Nuk plotëson pikën 2.3 b) të Kapacitetit Teknik, Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi nuk është paraqitur asnjë Çertifikatë Origjine ose Çertifikatën EUR1 për biocidet, insekticidet, dhe rodenticidet e importuara (Nr. Rendor 1 deri 12 të listës së paraqitur në tabelën e Shtojcës Nr.10).

17. Nuk plotëson pikën 2.3 a) të Kapacitetit Teknik, Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi nuk është paraqitur autorizim prodhuesi ose distributor zyrtar për produktin nr. **9 Insekticid për luftimin e furrtareve** (Foval Gel Ultra Scarafaggi, prodhues Kollant s.r.l, Itali).

18. Nuk plotëson pikën 2.3 i) të Kapacitetit Teknik, Shtojca 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi mostrat e paraqitura nuk janë paraqitur sipas kërkesave të DST. Mostrat e produkteve nr.6, 7 8, 9, 10, 11, 12 sipas renditjes të paraqitur në Shtojcën 10 dhe Shtojcën 12 nuk janë paraqitur në paketim origjinal dhe nuk identifikohet prodhuesi i tyre.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Milifar**” sh.p.k me **NIPT J81426001I** me seli në adresë: Rruga “Xhorxhi Martini”, Pall.9, Tiranë, me ofertë ekonomike **33 561 200** (*tridhjetë e tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind*) **lekë pa tvsh**, e paraqitur për tenderin me objekt; “**Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim**”, me afat të lëvrimin deri **24 muaj** nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Tiranë, Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tiranë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për lidhjen e kontratës nga AK.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura do të anulohet, sipas përcaktimeve të nenit 24 pika 1 ç) të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 10/03/2021

Ankesa: Ka pasur. Është depozituar ankim pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik pjesëmarrës “**Albania Distribution Chem**” sh.p.k me **NIPT L82203011N**. Autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje duke refuzuar ankesën dhe ka njoftuar ankimuesin më datë 17.03.2021.

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erindi Bejko